



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 16/09**

**Prishtinë, më 27.01.2009, ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Sadik Idriz, Numan Balić, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Zafir Berisha Xhevdet Neziraj.

Anëtarët jo të pranishëm: Enis Kervan, Mursejl Haljilji, Zylfi Merxha, Hetem Arifi.

Gjithashtu të pranishëm ishin: moniturores nga Zyra e Presidentit, KDI, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

**Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 1 dhjetor 2008**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-20 për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, me raportin e komisionit funksional -Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor me raportin komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe planifikim Hapësinor, me amendamente**
- 5. Të ndryshme**

**Kryesuesi**, përshëndeti të pranishmit dhe urojë punë të mbarë për vitin 2009. Theksoi se vitin e kaluar kemi pasur bashkëpunim të mirë dhe kemi realizuar detyrat dhe punët e paraqitura para

komisionit me sukses. Njoftoi se në bashkëpunim me stafin mbështetës do të hartojnë raportin vjetor të punës si dhe njëkohësisht planin e punës për vitin 2009. Më pas hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 1 dhjetor 2008**

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 1 dhjetor 2008, u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-20 për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, me raportin e komisionit funksional -Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-20 për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor me raportin komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

## 5. Të ndryshme

**Sadik Idriz**, duke ditur agjendën e ngjeshur dhe mundësinë që seanca plenare të zgjat edhe ditën e premte, propozoi që mbledhja e parapare për këtë ditë të mbahet të Mërkurën.

**Müfera Şinik dhe Kosara Nikolić**, kërkuan të koordinohet mbledhja duke pasur parasysh mundësinë e mbajtjes së seancës plenare.

**Sanije Aliaj**, propozoi që mbetet mundësia e mbajtjes së mbledhje të premten, të gjindet një kohë në gjatë pauzës së seancës dhe të realizohet takimi.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Mbledhja e radhës së Komisionit mbahet të Premten në kohën e parapare. Ndërsa nëse do të ketë seancë plenare, mbledhja do të mbahet pas përfundimit të seancës.

**Kryesuesi**, lidhur me punën për vitin e kaluar, theksoi se ka mundësi se dikush nuk është i kënaqur, por se ai është munduar maksimalisht që komisioni t'i kryej detyrat dhe çështjet e parashtruar, dhe Komisioni të mos jetë pengesë për punën e Kuvendit. Premtoi se lidhur me ngecjen e Projektligjit për Banesat do të bie në kontakt me përfaqësuesit e ICO dhe përfaqësuesit tjerë të angazhuar, në mënyrë që Komisioni të kryej punën dhe të jap rekomandimet për Kuvendin. Sa i përket aktiviteteve këtë vit, theksoi se ato do të pasqyrohen në planin e punës.

**Sanije Aliaj**, vlerësoj punën konstruktive për të ecur përpara. Lidhur me vizitat e realizuara nëpër komuna, kërkoj që këtë vit të përgatiten më mirë, e jo sikurse me vizitën në Ferizaj në të cilën nuk jemi pritur nga udhëheqja komunale, kur dihet fakti se është një komunë që ka arritur rezultate të mira sa i përket integritimit të komuniteteve dhe lirisë së lëvizjes. Kërkoj që këtë vit të realizohen ato objektiva që do të parashihen në planin e punës.

**Sadik Idriz**, kërkoj që Komisioni të trajtoj rastin e mos emërimit të një kandidati nga radhët e komunitetit boshnjak për anëtar të këshillit në Institutin Gjqësor. Kërkoj që komision përveç shqyrtimit të projektligjeve, të ngris zërin edhe për këto çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve.

**Kosara Nikolic**, duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Idriz, theksoi se në këto raste nuk duhet gjykuar në bazë të se ku ka punuar në të kaluarën, por në bazë të aftësive profesionale. Prandaj u pajtua që Komisioni duhet trajtuar këto raste.

**Sanije Aliaj**, duke komentuar rastin mosvotimit të kandidatit për anëtarë të Këshillit të Institutit Gjqësor, theksoj se deputetët në Kuvendi kanë shikuar biografinë e kandidatit në bazë të saj kanë votuar kundër. Kuvendi ka votuar kundër kandidatit dhe nuk është votuar kundër komunitet. Kjo

ndodh edhe me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve nga radhët e komunitetet shumicë. Paraprakisht anëtarët e komunitetit të caktuar është dashur të marrin informacione për kandidatin.

**Sadik Idriz**, theksoi se nuk e ka njohur kandidatin, dhe se arsyeja e mostrajtimit të rastit të tij është bërë për shkak se nuk e kanë pasur biografinë në gjuhën shqipe. Si komisioni nuk mund t'i bindim deputetët se si votojnë, por se duhet marrur një qëndrim apo rekomandim për rastin në fjalë në mënyrë që mos të gjykohet kandidati për shkak të angazhimit të tij në punë para 1999, sepse i njëjti ka punuar në institucione edhe pas kësaj periudhe.

**Numan Balić**, duke komentuar refuzimin e rritjes së buxhetit për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, theksoi se organet përkatëse duhet të japin përgjegjësi institucionale për një kundërshtim të tillë. Theksoi se buxheti i kësaj Ministrie duhet gjithësesi të rritet me rastin e rishikimit të buxhetit. Ndërsa lidhur me diskutimet për kandidatin e refuzuar për anëtar të këshillit të Institutit të Gjyqësisë, theksoi se kandidati ka bërë gabim për shkak se ka mbushur biografinë në gjuhën shqipe dhe jo në atë boshnjake, komunitetit të cilit i takon. Megjithatë si Komisioni duhet të reagojmë për të mbrojtur të drejtat e komuniteteve.

**Kryesuesi**, theksoi se ai personalisht ka votuar për kandidatin duke përjashtuar paragjykimet se ku ka punuar në të kaluarën. U përkujtohet se si Komisioni duhet trajtuar këto raste dhe duhet reaguar gjithmonë kur shkelen të drejtat dhe interesat e ndonjë komuniteti.

Mbledhja përfundoi në ora 12:40

Përgatitur nga  
Njësia për mbështetjen e Komisionit

**Kryesuesi i Komisionit,**  

---

**Bojan STOJANOVIĆ**